

ZYRA KOMBETARE E AUDITIMIT NACIONALNA KANCELARIJA REVIZIJE / NATIONAL AUDIT OFFICE			
DATE/PRANUAR DOKLJUAR: DATUM PRIBIJE DOSTAVLJEN: DATE RECEIVED/SUBMITTED: - 9. 10. 2020			
Njësia Org. Org. Jedin. Org. Unit	Shif. klasif. Klasif. Kod Class. Code	Nr. Prot. Br. Prot. Prot. No.	Nr. i faqeve Br. Stranica No. Pages
06	47	1488	5



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo  
Qeveria – Vlada – Government

Ministria e Punëve të Brendshme / Ministarstvo Unutrašnjih  
Poslova / Ministry of Internal Affairs

Policia e Kosovës / Policija Kosova / Kosovo Police

Drejtoria e Përgjithshme e Policisë / Generalna Policijska  
Direkcija / General Police Directorate

01/0031 5  
20/01/2020  
PRISHTINË-PRISTINA-PRISHTINE

LISTË DISTRIBUIMI/ CIRKULARNO PISMO/ ROUTING SLIP

REFERENCË:			
PËR/ZA/TO:	z. Besnik OSMANI Auditor i Përgjithshëm		
CC:			
PËRMES/PREKO/THROUGH:			
NGA/OD/FROM:	Rashit QALAJ Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës		
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Plani i Veprimit – Adresimi i Rekomandimeve nga Raporti i Auditimit të Performancës, dhjetor 2019 - "Siguria në trafikun rrugor"		
Nr. i zyrës: Br. kancelarije: Room No.:	Lokacioni: Kucni: Extension:	Policia e Kosovës	Data: Datum: Date:
			20.01.2020
PËR AKTIVITET/ZA AKTIVNOSTI/FOR ACTION			<input type="checkbox"/>
PËR MIRATIM/ZA USVAJANJE/FOR APPROVAL			<input type="checkbox"/>
PËR NËNSHKRIM/ZA POTPIS/FOR SIGNATURE			<input type="checkbox"/>
PËR KOMENTE/ZA KOMENTARE/FOR COMMENTS			<input type="checkbox"/>
A MUND TË DISKUTOJMË/DALI MOZIEMO RASPRAVLJATI/MAY ËE DISCUSS			<input type="checkbox"/>
VËMENDJA JUAJ/VASA PAZNJA/YOUR ATTENTION			<input type="checkbox"/>
SIPAS DISKUTIMIT/KAKOJE RASPRAVLJENO/AS DISCUSSED			<input type="checkbox"/>
SIÇ ËSHTË KËRKUAR/KAKO JE ZATRAZENO/AS REQUESTED			<input checked="" type="checkbox"/>
SHËNIM DHE PËRGJIGJE/BELESKA I ODGOVOR/NOTE AND RETURN			<input type="checkbox"/>
PËR INFORMIMIN TUAJ/ZA VASU INFORMACIJU/FOR YOUR INFORMATION			<input checked="" type="checkbox"/>
AFATI/KRAJNI ROK/DEADLINE			<input type="checkbox"/>

I nderuar,

Ju njoftojë së në bashkëngjitje të kësaj shkrese ju dërgojmë Planin e Veprimit – Adresimi i Rekomandimeve nga Raporti i Auditimit të Performancës, dhjetor 2019 - "Siguria në trafikun rrugor".

Me respekt

Faqe 1 nga 1

Adresa: Rr. Luan Haradinaj pn. 10000 Prishtinë – Kosovë  
Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Kosovës

**Plani i Veprimit – Adresimi i Rekomandimeve nga Raporti i Auditmit të Performancës, dhjetor 2019**

**“SIGURIA NË TRAFIKUN RRUGOR”**

Plani i veprimit për implementimin e rekomandimeve të dhëna nga Raporti i Auditmit të Performancës, dhjetor 2019			
“SIGURIA NË TRAFIKUN RRUGOR”			
Nr.	Rekomandimi	Prioritet	Plani i veprimit
1	Të bëjë regjistrimin e plotë dhe me kohë të të dhënave në Sistemin Informativ të Policisë së Kosovës, duke bërë unifikimin e tij, në mënyrë që Policia e Kosovës të identifikoj qartë faktorët dhe shkaktarët e aksidenteve. Hartimi i raporteve dhe planifikimi i resurseve për të ofruar siguri në trafikun rrugor përmes kontrolleve policore, të bazohet në të dhënat e detajuara me faktorë dhe shkaktarë të aksidenteve të regjistruara në këtë sistem.	<i>I tërë rekomandimi</i>	Policia e Kosovës është duke i evidentuar të dhënat e kundërvajtjeve (tiketat) dhe aksidenteve në Sistemin Informativ të Policisë së Kosovës (SIPK). Ndërsa, do të kërkohet nga të gjitha njësitë dhe stacionet policore që të gjitha të dhënat të cilat duhet të futen në sistemin SIPK të jenë të evidentuara me kohë, me c’rast hartimi i raporteve, planifikimi i resurseve dhe planifikimi i aktiviteteve duke përfshirë edhe orarin, të jetë i bazuar në gjendjen e sigurisë së trafikut rrugor (statistika dhe analiza), faktorët, shkaktarët e aksidenteve dhe kundërvajtjeve. Rrjedhimisht, do t’i kushtohet kujdes në vazhdimësi që këto veprime të bazohen në të dhënat e evidentuara dhe të dhënat statistikore me qëllim që të vendosen veprime të qarta konform tyre.
2	Njësia Rajonale e Komunikacionit Rrugor - Prishtinë të siguroj mbulimin e të gjitha regjioneve/segmenteve rrugore me kontrolle policore dhe brenda tyre të orientoj kontrollet policore duke u fokusuar në rrugët me rrezikshmëri të lartë. Të caktoj qartë dhe saktë	<i>I tërë rekomandimi</i>	Përveç NJRKRR Prishtinë ky rekomandim do të ju adresohet të gjitha njësiteve të trafikut që aktivitetet e tyre në mbulimin e terrenit t’i mbështesin në identifikimin e vendeve ku kanë ndodhur më së shumti aksidente dhe që konsiderohen si vende të rrezikshme.

	<p>vendin ku duhet të kryhen kontrollet në oraret kontrolluese dhe në planet e punës të evidentoj shfrytëzimin e pajisjeve (radarëve dhe alkool testeve); përforsimi i kontrolleve rrugore nga ana e policisë jo vetëm në pika statike, por duke aplikuar edhe monitorimin në lëvizje të përdoruesve të rrugës dhe përmes aplikimit teknologjive të reja të sigurisë rrugore.</p>		<p>Po ashtu do të kërkohet që në orarin ditor të punës të evidentohet edhe pikat e kontrollit, pajisjet (radarë dhe alkooltest) si dhe do të vazhdohet me patrullim të kombinuar, përfshirë pika kontrolli të automjeteve dhe patrullimi në lëvizje, duke përdorur pajisjet aktuale të mbikëqyrjes së trafikut.</p>
3	<p>T'i kushtohet rëndësi më e madhe rritjes së nivelit të informimit dhe ndërgjegjësimit për siguri rrugore me anë të shërbimeve këshillimore dhe inkurajimit të përdoruesve të rrugës që të respektojnë normat ligjore si dhe kontrolle më të shpeshta të gjendjes dhe pajisjeve të sigurisë të cilat duhet t'i kenë mjetet.</p>	<p><i>I tërë rekomandimi</i></p>	<p>Në çdo plan paraprak të punës, përfshirë edhe vitin aktual njëri prej aktiviteteve është edhe ngritja e vetëdijesimit të pjesëmarrësve në trafikun rrugor, përmes projekteve/fushatave vetëdijesuese. Gjithashtu, në vazhdimësi Policia e Kosovës, konkretisht Divizioni i Komunikacionit Rrugor është duke realizuar emisione, intervista në media, komunikata, ligjërata në shkolla si dhe apele të ndryshme, qëllimi i të cilave është këshillimi dhe sensibilizimi i pjesëmarrësve në respektimin e rregullave dhe shenjave të trafikut rrugor. Ky sensibilizim është duke u realizuar në disa forma të informimit/ndërgjegjësimit, si: përmes shpërndarjes së materialeve nga zyrtarët policor, mediave të shkruara dhe elektronike si dhe janë duke u shfrytëzuar maksimalisht rrjetet sociale zyrtare të Policisë së Kosovës, gjë që do të angazhohemi edhe më tutje në aktivitete të tilla sensibilizuese.</p> <p>Ndërsa, lidhur me pajisjet e sigurisë në mjete, do të kërkohet nga njësitë e trafikut që të shtohet kontrolli për pajisjet rezervë dhe shtesë në mjete.</p>
4	<p>Sensibilizimin e ngasësve që të evitohen shpejtësitë e mëdha, të vendoset rripi i sigurisë, të</p>	<p><i>I tërë rekomandimi</i></p>	<p>Do të vazhdohet edhe më tutje në sensibilizimin e pjesëmarrësve në trafikun rrugor duke përfshirë edhe rekomandimin në fjalë. Përveç këtyre do të bëjmë përpjekje</p>

	evitohet përdorimi i telefonit gjatë vozitjes, përdoruesit e motoçikletave të bartin helmetën mbrojtëse, vozitësit profesional të automjeteve të rënda të respektojnë orët e vozitjes dhe të pushimit si dhe të përdorin tahografët digjital etj.		që të realizojmë projekte bazuar në gjendjen e sigurisë në trafikun rrugor, faktorët dhe shkaktarët më të shpeshtë të kundërvajtje dhe aksidenteve, duke bashkëpunuar edhe me akterët tjerë relevantë.
5	Të shqyrtojë aplikimin e alternativave tjera siç është vendosja e kamerave përcjellëse dhe atyre statike për matjen e shpejtësisë nëpër rrugët rajonale dhe lokale në mënyrë që të rrisë sigurinë në trafikun rrugor.	<i>I tërë rekomandimi</i>	Do të vazhdohet bashkëpunimi dhe bashkërendimi me Drejtorinë e Teknologjisë Informative, Drejtorinë e Logjistikës dhe Drejtorinë e Prokurimit në Policinë e Kosovës, në inicimin dhe realizimin e projekteve të avancuara sa i përket identifikimit dhe dëshmimit të kundërvajtjeve në trafikun rrugor, që përfshinë edhe pajisjet për matjen e shpejtësisë, e të cilat janë në domenin e Policisë së Kosovës. Gjithashtu, bazuar në legjislacionin në fuqi, do të bashkëpunohet edhe me institucionet qendrore dhe lokale sa i përket rregullimit teknik të trafikut në veçanti sistemin e rregullimit teknik të qarkullimit rrugor nëpërmes sistemit elektronik dhe të video mbikëqyrjes.
6	Njësia Rajonale e Komunikacionit Rrugor - Prishtinë të fokusohet në aktivitetet e saj kryesore në trafik siç është parandalimi i aksidenteve dhe pastaj përmes një planifikimi më të mirë, të angazhohet në aktivitetet tjera dytësore.	<i>I tërë rekomandimi</i>	Prioritet i njësive të trafikut është dhe do të jetë parandalimi i aksidenteve, rregullimi dhe kontrollimi i trafikut rrugor. Në bashkëpunim dhe koordinim në mes të nivelit qendror dhe lokal të Policisë së Kosovës, njësitë e trafikut do të jenë të angazhuara në ofrim të sigurisë rrugore dhe parandalim të aksidenteve për çka është detyrë primare e tyre, gjithashtu do të bëhen përpjekje që njësitë e trafikut të jenë sa më pak të angazhuara në aktivitete të tjera dytësore, përjashtimisht kur një gjë e tillë kërkohet të realizohet nga njësitë e trafikut.

7	Divizioni i Komunikacionit Rrugor të hartojë dhe zbatojë plane dhe të përgatisë raporte të mbikëqyrjes në baza të rregullta tre mujore përgjatë gjithë vitit.	<i>I tërë rekomandimi</i>	<p>Si çdo vit tjetër edhe në vitin aktual (2020) në kuadër të planit vjetor të punës, janë paraparë inspektime në njësitë e trafikut me qëllim të pasqyrimin të gjendjes dhe përmirësimit të saj, përmes të gjeturave nga inspektimet.</p> <p>Përveç inspektimeve të planifikuara, varësisht prej gjendjes së sigurisë në trafikun rrugor do të realizohen edhe inspektime Ad Hoc, me qëllim të realizimit të aktiviteteve dhe detyrave në terren nga njësitë e trafikut.</p> <p>Do të angazhohemi që përmes këtyre aktiviteteve të ndikojmë në ngritjen e performancës dhe imazhin e njësive të trafikut rrugor.</p>
8	Njësia Rajonale e Komunikacionit Rrugor - Prishtinë të përfshijë në planin vjetor të punës procesin e mbikëqyrjes së njësive kontrolluese nga menaxhmenti dhe të sigurojë implementimin e tij. Të bëhen plane të inspektimit nga udhëheqësi i Njesisë Rajonale të Komunikacionit Rrugor Prishtinë dhe udhëheqësi i operativës. Të bëhet monitorimi i realizimit/implementimit të planeve operative kontrolluese policore nga mbikëqyrësi i parë i ekipeve patrulluese, po ashtu të sigurohet mbikëqyrja ndaj mbikëqyrësit të parë.	<i>I tërë rekomandimi</i>	Përveç NJRKRR Prishtinë ky rekomandim do të ju adresohet të gjitha njësive të trafikut që në planet e tyre të përfshihen edhe aktivitetet e mbikëqyrjes dhe inspektimit nga stafi mbikëqyrës (udhëheqësi i njësisë, udhëheqësi i operativës, mbikëqyrësi i ekipit patrullues dhe mbikëqyrësitë tjerë në kuadër të njësive).

20.01.2020

Me respekt

